



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Nr. 12 prot.

Korçë, më ____ . ____ 2025

INFORMACION

**“MBI PROJEKTET E FITUARA NGA KËSHILLI I QARKUT KORÇË NË
PROGRAMIN INTERREG IPA CBC GREQI SHQIPËRI 2021 -2027**

**A- PROJEKTI “PËRMIRËSIMI NDËRKUFITAR I AKSESUESHMËRISË,
EFEKTIVITETIT DHE QËNDRUESHMËRISË SË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE
SOCIAL TË BAZUAR NË KOMUNITET” – “HEALTH4ALL”**

Projekti **“Health4All”** është një iniciativë ndërkufitare me qëllim kryesor përmirësimin e aksesit, efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve shëndetësore dhe sociale, duke u fokusuar në kujdesin shëndetësor dhe social të bazuar në komunitet. Ky projekt është pjesë e programit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA CBC 2021-2027, dhe ka si qëllim të kontribuoni në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të rajonit, duke përmirësuar kushtet e shëndetit dhe kujdesit social për individët, pa marrë parasysh kufijtë administrativë.

Ky projekt ka për qëllim të sigurojë një qasje të barabartë dhe të integruar ndaj kujdesit shëndetësor dhe social për grupe vulnerabël, me theks të veçantë për të moshuarit që jetojnë në kushte të vështira, si dhe për ata që janë të prekur nga izolimi social. Objektivi i këtij projekti është të ofrojë mundësi për integrimin e këtyre grupeve në shoqëri, përmes rritjes së cilësisë së shërbimeve dhe përmirësimit të kushteve të jetesës, si dhe për të garantuar mbrojtjen dhe përkujdesjen që ata meritojnë.

Aktualisht, Këshilli i Qarkut Korçë, në bashkëpunim me Bashkinë Korçë, Bashkinë Maliq, Bashkinë Pogradec, dhe Misionin Emanuel, ka ndërtuar një sistem të avancuar monitorimi dhe zhvillimi për qendrat sociale të përkujdesit ndaj të moshuarve. Ky sistem ka siguruar mbështetje të nevojshme për zgjerimin dhe forcimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke u implementuar në përputhje me fondin social dhe standardet kombëtare të shërbimeve, si dhe me planet sociale të bashkive përkatëse. Qëllimi kryesor është të sigurohet mbrojtja, përkujdesi, integrimi dhe përfshirja e të moshuarve të vetmuar, duke mundësuar që ata të marrin kujdesin dhe mbështetjen e nevojshme për të përballuar sfidat e jetës së përditshme.

Për të përmirësuar këto qendra, projekti i fituar nga programi IPA CBC midis Greqisë dhe Shqipërisë do të kontribuoni në avancimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale, duke rritur cilësinë e kujdesit për individët e moshuar, veçanërisht ata që jetojnë në kushte të vështira, si dhe duke siguruar përmbushjen e nevojave të këtyre grupeve vulnerabël. Ky projekt do të mbështesë përmirësimin e kushteve të kujdesit për të moshuarit dhe individët me nevoja speciale përmes

ofrimit të një game të gjerë pajisjesh dhe infrastrukturash të nevojshme, me qëllim sigurinë dhe përmirësimin e kujdesit të ofruar.

Një nga komponentët kyç të këtij projekti është blerja e pajisjeve të specializuara për kujdesin e të moshuarve, të cilat përfshijnë karrige me rrota, pajisje mbështetëse për fizioterapi dhe mbështetje të mobilitetit, dyshekë me presion të alternuar për përmirësimin e kushteve të shëndetit dhe lëvizshmërisë, karrige komode dhe pajisje të tjera mbështetëse që ndihmojnë në përmirësimin e lëvizshmërisë dhe lehtësimin e kujdesit të përditshëm. Po ashtu, një element i rëndësishëm është transporti për persona me aftësi të kufizuara dhe jo vetëm i cili do të mundësojë lëvizjen e sigurt dhe efikas të individëve që kanë nevojë për kujdes mjekësor dhe për të shkuar në qendrat shëndetësore dhe sociale.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i këtij projekti është ndërtimi i një sistemi të ri monitorimi dhe kujdesi për të moshuarit, i cili do të përdorë teknologjinë e **GIS (Sistemi Gjeografik i Informacionit)** për të monitoruar dhe menaxhuar në kohë reale statusin e kujdesit ndaj të moshuarve dhe individëve të vetmuar. Ky sistem do të përfshijë një platformë **WebGIS**, e cila do të mundësojë krijimin e një harte dinamike që pasqyron statusin e shëndetit dhe ndërveprimet sociale të të moshuarve, duke ndihmuar në identifikimin dhe zgjidhjen e nevojave të tyre shëndetësore dhe sociale. Platforma do të sigurojë gjithashtu dërgimin e alarmeve automatikë në raste mungese kontakti, duke mundësuar një reagim të shpejtë dhe efikas për të siguruar që individët të marrin kujdesin e nevojshëm në kohë. Ky sistem do të menaxhojë edhe rrjetin social dhe statusin e kujdesit ndaj të moshuarve dhe individëve të vetmuar, duke siguruar që ata të kenë mbështetje të vazhdueshme dhe të parandalohen krizat sociale, të cilat mund të shkaktojnë rasoja të rënda në jetën e këtyre individëve.

[Ne proces finalizimi]

B- PROJEKTI STRATEGJIK "TRANSPORT "SMART" I ZGJUAR, DHE I GJELBËR PËR NJË EKONOMI TË GJELBËR NË ULJEN E NDOTJES SË AJRIT" - GST- GERA

Projekti **GST-GERA** ka si qëllim kryesor përmirësimin e kushteve të mjedisit dhe sistemit të transportit në nivel rajonal, duke kontribuar në zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe të gjelbër. Ky projekt synon të mbështesë kalimin e rajoneve drejt një modeli më të gjelbër, duke promovuar përdorimin e transportit elektrik dhe të zgjuar, që do të ndikojë drejtpërdrejt në uljen e ndotjes së ajrit dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës për qytetarët, si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale.

Një nga komponentët kryesorë të projektit është ofrimi i dy autobusëve elektrikë, me kapacitet nga 14 deri në 30 pasagjerë. Këta autobusë do të ofrojnë një zgjidhje efikase dhe të qëndrueshme për transportin publik, duke mbështetur nevojat e orëve të pikut dhe duke përmirësuar linjat ekzistuese, veçanërisht për studentët e Universitetit "Fan S. Noli".

Ky sistem pilot i transportit elektrik do të ndihmojë në:

- Ulja e emetimeve të gazrave;

- Përmirësimin e cilësisë së ajrit;
- Krijimin e efikasitetit të shërbimit të transportit publik.

Projekti përfshin gjithashtu ndërtimin e infrastrukturës për karikimin e autobusëve elektrikë, duke krijuar një sistem transporti të pastër dhe të qëndrueshëm. Pikat e karikimit do të vendosen në tri bashki të Qarkut të Korçës: Korçë, Kolonjë dhe Devoll, dhe do të mundësojnë transportin e autobusëve për distanca të gjata.

Për të siguruar monitorim të vazhdueshëm të cilësisë së ajrit, autobusët elektrikë do të pajisen me sensorë të avancuar. Këta sensorë do të lejojnë matjen e cilësisë së ajrit në kohë reale gjatë udhëtimeve dhe do të sigurojnë të dhëna të vlefshme për hartimin e masave specifike për përmirësimin e kushteve mjedisore dhe minimizimin e ndikimeve negative të ndotjes. Projekti përfshin një bashkëpunim të ngushtë me **Universitetin "Fan S. Noli"**, i cili do të luajë një rol të rëndësishëm në: Zhvillimin e sistemit të monitorimit; Analizën e të dhënave mbi ndotjen e ajrit; Vlerësimin e ndikimit të transportit elektrik në klimë. Rezultatet e studimeve do të ndihmojnë në optimizimin e procesit të transportit dhe në zhvillimin e politikave dhe strategjive të qëndrueshme për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e një ekonomie të gjelbër në rajon.

Projekti strategjik **GST-GERA** është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të një infrastrukture transporti të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin. Ai do të kontribuojë në uljen e ndotjes së ajrit, përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët si dhe zhvillimin e një të ardhmeje të pastër dhe të qëndrueshme për rajonin dhe shoqërinë në tërësi. Me ndihmën e teknologjisë moderne dhe bashkëpunimin me institucione të specializuara, projekti synon të realizojë një transport elektrik efikas dhe të pastër, duke mbështetur një mjedis më të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm në rajonin e Korçës.

Koncept. Dr. Kab & Kësh. për Projektet e BE: M. Alickolli

KABINETI I KRYETARIT

